



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 610 Prot.

Tiranë, më datë 14.04 2020

VENDIM

Nr. 126, datë 14.04.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", pas shqyrtimit më parë të kriterëve në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.04.2020,

VENDOSI:


1. Miratimin e kriterëve për rjetëzimin dhe shfrytëzimin e Ansamblit Historik Urban "Ruga Justin Godard", "Ruga e Hebrenjve" dhe disa monumenteve të shpallura brenda zonës së ndërhyrjes në kuadër të projektit "Rikualifikimi në zonën e mbrojtur urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë: Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstrukcioni i objekteve të tjerë", Vlorë, me subjekt aplikues AADF, të miratuar në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve Nr. 60, datë 5.02.2017;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elyza MARGARITI





**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR RIJETËZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E ANSAMBLIT HISTORIK URBAN “RRUGA JUSTIN GODARD”, “RRUGA E HEBRENJVE” DHE DISA MONUMENTEVE TË SHPALLURA BRENDA ZONËS SË NDËRHYRJES NË KUADËR TË PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI NË ZONËN E MBROJTUR URBANE PRANË QENDRËS SË QYTETIT VLORË: HARTIMI I PROJEKTIT URBAN, RESTAURIMI I MONUMENTEVE TË KULTURËS NË KËTË ZONË DHE RIKONSTRUKSIONI I OBJEKTEVE TË TJERË”, VLORË, ME SUBJEKT APLIKUES AADF, TË MIRATUAR NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË RESTAURIMEVE NR. 60, DATË 5.02.2017**

**Pika 1**

**Qëllimi**

1. Vendosja e kriterëve për rijetëzimin dhe vënia në shfrytëzim të Ansambllit Historik Urban “Rruga Justin Godard” dhe “Rruga e Hebrejve” në qytetin e Vlorës, ka për qëllim :
  - të nxjerrë në pah vlerat arkitektonike të njësive përbërëse;
  - të bëhet pjesë e rëndësishme aktive e jetës së qytetit;
  - të shërbejë në zhvillimin e turizmit kulturor, por në të njëjtën kohë përdorimi i tij nuk duhet të çënojë vlerat e monumentit.
2. Këto kriterë bazohen në Ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”

**Pika 2**

**Statusi ligjor**

Ansambli Historik Urban “Rruga Justin Godard” është shpallur në mbrotje me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 249, datë 01.07.1980. Ansambli Historik Urban “Rruga e Hebrejve” është shpallur në mbrotje me Urdhër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Nr. 469, datë 09.08.2006. Si dhe këto dy ansamble ndodhet brenda kufirit të Zonës Arkeologjike B të qytetit të Vlorës, shpallur me Vendim Nr. 729, datë 01.09.2010.

**Pika 3**

**Pjesët përbërëse të Ansambllit Historik Urban**

Pjesët përbërëse të Ansambllit Historik Urban “Rruga Justin Godard” dhe “Rruga e Hebrejve” në qytetin e Vlorës janë: ndërtesat, rrjeti rrugor me sheshet funksionale dhe ambientet ndihmëse që ndodhen brenda kufirit të tyre.

**Pika 4**

**Kriteret e shfrytëzimit**


1. Ndërtesat që përbëjnë Ansambllin Historik Urban “Rruga Justin Godard” dhe “Rruga e

Hebrenjve" si dhe hapësirat publike të tyre, shfrytëzohen sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos çenojnë vlerën e monumentit.

Funksionet e këtyre objekteve dhe hapësirave publike parapëlqehet të jenë ato origjinale të prodhimit shërbim, tregtim dhe bujtje (akomodim), të cilat janë ende të nevojshme për nevojat e sotme të popullsisë. Por në çdo rast ky funksion, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore

3. Rijetëzimit të Ansamblit Historik Urban mund t'i shtohen edhe funksione të reja, të cilat nuk bien ndesh me funksionet fillestare të tij por ndihmojnë në gjallërimin e ansamblit dhe në plotësimin e kërkesave të shoqërisë së sotme. Këto funksione nënkuptojnë aktivitete, të cilat janë tepër të nevojshme për qytetarët dhe turistët që do të qarkullojnë në këtë zonë. Të tilla mund të jenë:
  - a) të karakterit ekonomik-informativ (njësi bankare, agjensi këmbimi monedhe, pika informacioni, agjensi turistike etj.),
  - b) të karakterit rekreativ (restorante, taverna, kafene, bare etj.),
  - c) të karakterit kulturor në objekte që ndodhen në pika strategjike si sheshe etj (psh. Muzeu i Hebrejve në godinat pranë Muzeut Etnografik, studio dhe galeri artistësh, qendra të kulturës vlonjate, pika koncertesh, parqe lojërash për fëmijë etj),
  - d) për pasuritë kulturore me status "monument kulture" brenda Zonës së Studimit, propozohet funksioni si më poshtë:
    - "Muzeu Historik" funksioni i pandryshuar;
    - "Kompleksi tek Muzeu "Rr. 8 Marsi" funksion tregtar, artizanati dhe shërbimi;
    - "Kompleksi mbi muzeun" funksion tregtar, artizanati dhe shërbimi;
    - "Kulla e Sahatit" funksion social kulturor dhe shërbimi;
    - "Ish Galeria e Arteve" funksion tregtar dhe galeri arti për artistët;
    - "Godinë viti 1925 "Rr. Zogu i I" funksion tregtar dhe shërbime hotelerie;
    - "Godinë dy kat "Rr. Zogu i I" funksion tregtar dhe shërbime hotelerie;
    - "Banesa pranë "Klubit Labëria" funksion muze;
    - "Banesa ku në vitin 1908 u ngrit Klubi Patriotik Labëria" funksion muze;
    - Ish "Hetuesia" funksion tregtar, shërbime hotelerie, qëndër social kulturore;
    - "Bashkia e qytetit" funksion i pandryshuar.
4. Brenda Ansamblit Historik Urban ndalohet tregtimi i produkteve dhe ekspozimi i tyre në trotuaret dhe sheshet publike.
5. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese brenda ansamblit historik urban dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga Ministria e Kulturës, IKTK, DRTK Vlorë dhe miratohen me Urdhër Ministri.
6. Destinacionet e objekteve të Ansamblit Historik Urban ose ndryshimi i tyre miratohet nga Bashkia Vlorë, si dhe Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

7. Në rastet e shfrytëzimit të hapësirave publike brenda Ansamblit Historik Urban për destinacione të përkohshme, leja do të miratohet sipas Ligjit 27/2018 “Për Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë”.



#### **Pika 5**

#### **Ndërhyrjet e lejuara**

Ndërhyrjet në Ansamblin Historik Urban “Rruga Justin Godard” dhe “Rruga e Hebrenjve” kryhen në përputhje të plotë me Ligjin 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, si dhe në Vendim Nr. 729, datë 01.09.2010 “Për Shpalljen e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit”. Për çdo ndërhyrje të lejuar duhet të kihet parasysh si më poshtë:

1. Të ruhen në tërësinë e tyre elementët e arkitekturës së jashtme të objekteve që përbëjnë Ansamblin Historik Urban, duke përfshirë këtu **ngjyrat, materialet dhe teknikën ndërtimore, elementët dekorativë dhe rifiniturat**
2. Të ruhet në tërësinë e tyre kompozimi i hapësirave publike, elementët e dekorit urban, ndriçimi dhe gjelbërimi.
3. Ndalohet tjetërsimi i kompozimit planimetrik dhe teknika e ndërtimit, në ndërtesat e Ansamblit Historik Urban.
4. Punimet e mirëmbajtjes dhe restaurimit të objekteve të Ansamblit Historik Urban kryhen pas miratimit të projektit në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale. Projektet hartohen nga institucionet shtetërore të specializuara në tarshëgimi kulturore ose nga subjekte të licënsuara në fushën e restaurimit.